

BIBLIOTEKA

E


604-9547

H27

SHTETIT

GJIROKASTËR

BEKIM
HARXHI



Mic
Sokoli
me shtatë
zemra

POEMË

851-93-1

H27.

BIBLIOTEKA E PIONIERIT


BEKIM HARXHI



Mic
Sokoli
me
shtatë zemra

poemë

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»




MBI GRYKËN E TOPIT MBETI PËRMENDORE

1.

Në Prizren u mblodh kuvendi,
dërgoi trimat gjithë vendi;
Nga Gjakova gjer në Vlorë
u mbush sheshi me dasmorë
dhe me pushkë dhe me kartë.
Ja Abdyli¹⁾ zemërjarrtë,
Ali Ibra, Sulejmani²⁾,
që të gjithë bij vatani,
përmbi shpata lidhën besën:

-
1. Abdyl Frashëri.
 2. Sulejman Vokshi.



«Ja të rrojmë, ja të vdesim!
Shtatë kralët le ta dinë,
s'është plaçkë trolli ynë
që të ndahet copë-copë
nëpër tregje në Evropë.
Le ta dijë Portë e Lartë,
Shqipëria s'është e ngratë,
se ka bij plot trimëri,
zemërdezur pér liri!
Mes kuvendit Mic Sokoli
Nja dy fjalë shkurt i foli:
«Besa jonë, o sot, o kurrë,
le të skuqë mbi flamurë,
përmbi shpata të na ndrijë,
si rrufe të shkrepëtijë,
dhe armiqjtë le të gjuajë,
se kjo tokë s'mban të huaj!»

2.

Dervish pasha kryelopa,
me taborë dhë me topa
nga Stambolli vjen me forë
Prizrenin të hedhë në dorë,
tokat të përpunjë zjarri,
të mos mbijë fije bari.



Dervish pasha, si mandatë,
ecën ditë, ecën natë,
në lugina, nëpër pyje,
nëpër mjegull, nënë hije,
nëpër vreshta, nëpër ara,
e shkretton ç'i del përpara.

3.

Mal më mal ndizen pishtarët,
brof në këmbë gjithë shqiptarët.

Rrokin armë dhe sëpata,
jataganë, kosa, shpata.

Luftëtarët, plot tri mijë,
zgjodhën Micin që t'u prijë.

Dhe me Micin trim me fletë
si shqiponja çajnë retë.

Nga nuk dolën, nga nuk erdhën,
që të kapin Ernalevën¹).

1) Gryka e Ceralevës.



Ernalevë shkëmb e gurë,
si ky prill s'ke parë kurrë.

Ai ty të ka ngarkuar
brezave për t'u treguar.

Nëpër këngë e nëpër valle
do të mbetesh lavdimadhe.

4.

Futet pasha në Kosovë,
ngriti kampin në Slivovë;
që nga çadra ngre dylbinë,
Ernalevës ia vë synë.

Ernaleva, grykë e fortë,
mbi Prizren qëndron si portë,
Ernaleva hijerëndë
si kala qëndron në këmbë.

Ernalevë shkëmb e brinjë,
pashës ç'ia vrave synë,

Ernalevë moj, të shkretën,
pashës ç'ia shkurtove jetën!

5.

Që nga Ernaleva
pus e zezë zbret nata,
brenda nëpër çadra
turqit i zë data.

Zbresin që nga shtigjet
trimat, si kaçakë,
me shpata vërtiten
përmbi turkoshakë.

Bie Mic Sokoli
posi shkrepëtimë,
çadrat marrin flakë,
turqit ulërijnë.

Kampi, si përbindësh,
gulçon me llahtarë,
përmbi truall ngrihen
pирже me të vrarë.



Pashës, nga zemërimi,
po i dridhet mjekrra,
drejt malit zgjat dorën
me gishtat si kthetra.

Vjellin tym e flakë
njëzet e ca topa,
u mbush Ernaleva
më predha dhe gropë.

Po nga gropat ngrihen
shpata edhe tyta;
për inat të pashës
zbukurohet gryka.

6.

Kërkon pasha Ernalevën
me dredhi ta marrë,
nis taborët më të zgjedhur
ta futin në darë.

Si hajdutë ecin, ngjiten
drejt grykës përpjetë,

i ndjek prapa nëpër shtigje
ky pashai vetë.

Ernaleva, si askurrë,
portat i ka zënë;
në fuçi, barut e gurë
trimat kanë vënë.

U mbush nata anembanë
me britma të çjerra;
turqit, ferrave i lanë
shallvaret e gjera.

Dhe pashai me shtatë tuje,
hipur përmbi kalë,
porsi hije, natës zhdukët
me bishtin në shalë.

Ernaleva u bë dritë
nga zjarri e flaka;
ç'bukuri që i ka dita,
ç'nur që i dha nata!

7.


Kampi turk s'ka gjumë,
kampi turk nuk fle,
Dervish pasha kampin
në këmbë e ngre.

Hipur përmbi kalë
me duf zë e flet:
— Beteja e fundit
nesër po na pret.

Tokën ta shkrumbojmë
me zjarr dhe barut,
në gjunjë ta ulim
ne çdo arnaut!

* * *

Flamurë, kuaj, topa,
lëvizin me ngut,
ngarkohen nëpër qerre
fuçitë me barut.




Ushtarët armatosen
e marrin çdo pajim;
në çadra hyjnë e dalin,
lëvizin pa pushim.

Lëviz i tërë kampi
e zien si kazan;
ç'i përgatit mëngjesit
kjo natë pis katran?!

Në çadër Dervish pasha
pi kafe me ibrik;
lëvrin në sy e buzë
mendimi i tij i lig.

Përjashta rrinë rojat
në këmbë si qirinj;
të gatshëm presin urdhrin
njëzet daullexhinj.

Përhapen këmbësorët
si brumbuj nëpër mal;
topçinjtë futin gjylet
e presin fjalën «zjarr».



REPRODUCED

N 76984

12611

Në çadër Dervish pasha
nxjerr orën me qostek;
nën dritën e fenerit
akrepat pas i ndjek.

Fitilin e një gjëme
në dorë sikur mban;
ç'po thur pér Ernalevën
kjo natë pis katran?!...

* * *

Dervish pasha shfryн bulçitë
dhe jep shenjën pér alarm;
të njëzet daullexhinxjtë
tundin dheun me tam-tam.

Topat zjarr e flakë vjellin,
sa një pus kjo grykë e tyre
duket sikur Ernalevën
do ta mbysin në mynxyrë.

Ngjiten malit të përpjetë
këmbësorët me «allah»,

ulérijnë si çakenjtë,
zbrzin armët në hava.

Rrokulliset natë e zezë
nëpër hone dhe sakaq
Ernaleva, mal i sertë,
si hanxharë kreshtat shfaq.

Hijerënda ato rrinë,
në vend shtanget kush s'i njeh,
para tyre, si me frymë,
sulmi osmanlli u shkreh.

Ç'po gjëmojnë daullet prapë,
topat rrahin më me ngulm;
Dervish pasha që nga çadra,
grah taborët për në sulm.

* * *

Dielli i mëngjesit
çukat përshtëndet,
një kurorë rrezesh
u hedh plot lezet.

Pasha vë dylbinë,
asgjë nuk shikon;
tymi i barutit
malin mjegullon.


Ndizet Dervish pasha
në fytyrë prush,
të pushtojë grykën,
dashka me çdo kusht.

Me britma e urdhra
çadra mbushet plot;
korrierët lëvizin,
frymë s'marrin dot.

Bashnizamët¹⁾ rrinë
gjithë sëkëlldi:
mund t'u përfundojë
koka në sini.

Një stuhi me krisma
Ernaleva ngre;

1) oficerë turq.



qindra osmanllinj
i përplas në dhe.

Me kryet të bardhë
si mali me borë,
thërret Sulejmani
dhe ia bën me dorë.

— Bini, burra, bini,
hasmit rrënjëdalë! —
si kushtrim i kishin
trimat këto fjalë.

Dhe me rrokullimë
nga vendi u shkulën,
si ortekë bore
mbi turqit u sulën.

* * *



Lulëkuqe plagë e parë
iu hap Micit përmbi ballë.

Në betejë trimi,
si në valle hidhet,
tehu i taganit
në ajër i dridhet.

Si krahë shqiponje
shokët i ka pranë,
dallgët e përleshjes
ngrihen anembanë.

Hidhet Mic Sokoli
edhe bën kërdi;
me tagan në dorë
kosit mizëri.

Kur iu hap dhe plaga e dytë,
trimave u hodhi sytë.

Smajli me një dorë,
si lis rri në këmbë
dhe shulin e pushkës
e shtrëngon me dhëmbë.



Lufton Shpend Elezi
me shpatë të thyer,
me gjakun e turqve
tehu krejt i lyer.

Piskat Ali Ibra
dhe hidhet pa frikë,
pesë a gjashtë armiq
i gremis me thikë.

Gjak kullon e treta plagë,
Mic Sokoli ndizet flakë.

Çallma, duar, shpata
dhe koka të prera,
të varura mbeten
në gjemba e ferra.

Kuajt vijnë rrötull,
me tmerr hingëllijnë,
mbi të vrarët shkelin,
marin arratinë.

Me ankth e me gjëmë
daullet u çanë;
Dervish pashës sytë
ç'lemeri i panë?!...

Kur e mori plagn' e katërt,
xhamadani iu hap flatër.

- Ndalu, Mic Sokoli,
se po të rrjedh gjaku!
- Për plagët e mia
nuk më zë meraku.



Me ujët e malit
dhe me gjethë prilli
sokoleshat tonë
prap' do të m'i mbyllin.

Po plagët e rënda
që ka sot vatani,
i mbyll grykëholla,
i shëron tagani.

Plumbi i pestë kur e mori,
një tagan të dytë nxori.

Hidhet Mic Sokoli
përmbi turkoshakë,
taganët në duar
shkrepin zjarr e flakë.

I kalojnë Micit
plumbat përmbi supe,
gjylet ngrenë shkulme,
trimat bëjnë tutje.

— T'ia hedhim katilit
zemrën në greminë,
Dervish pashës gjakun
hienat t'ia pinë!

Plumbi i gjashtë në krah i krisi,
iu bë krahu degë lisi.

Këmba Mic Sokolit
i shkel në gëzhoja;

i rrjedh gjak nga trupi,
me gjak iu mbush goja.

Tani di të flasë
vetëm me taganë;
në beteja trimat
këtë gjuhë kanë.

Eshtë gjuhë nderi,
e fortë si stralli;
me të nëpër shekuj
ka çarë shqiptari.

Plumbi tjetër, kur e mori,
iu ngrit dallgë kraharori.

Që nga shtatë plagët
gjaku rrjedh si gurrë,
po të shtatë zemrat
s'i pushojnë kurrë.

Hë, kjo grykë topi
udhën ç'na pengoka!

Predhat seç e mbushën
tokën gjithë gropë.

Mici bën me shenjë:
— Pas më ndiqni, trima,
ta mbytim të gjallë,
sa t'i zihet fryma!

* * *

Allah, allah, turqit
i mbërtheu frika,
kur u sul drejt topit
dhe iu hodh te gryka.

I vuri përpara
gjoksin si mburojë
dhe topit — kuçedër
iu mbyll ajo gojë.

Topi, i tërbuar,
po jep shpirt me grahmë,
ha veten përbrenda,
shpërthen me rropamë.



Reja i mbuloi
turqit artiljerë,
xhamadani i Micit
u shpërnda në erë.

Eh, o Mic Sokoli,
ç'bukuri që more,
mbi grykën e topit
mbete përmendore!

9.

Tak e tuk e tak e tuk,
këngë e djepave me dushk,
këngë e nënave plot hir:
«Mic Sokol m'u bëfsh, o bir!...»

Tak e tuk e tak e tuk,
këngë e tyre nuk ka fund,
frym në male si kushtrim:
«Mic Sokol m'u bëfsh, o trim!...»



FJALORTH SHPJEGUES

1. Ali Ibra — udhëheqës ushtarak i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit
2. kral-i-mbret
3. Portë e Lartë — pallati i sulltanit në Stamboll
4. me dorë — me bujë
5. trofe — ja-armët që i rrëmbehen armikut në luftë
6. tabor-i — botalion
7. tujë — a — shenjë grade që mbanin pashallarët
8. arnaut — i— dikur, kështu e quanin shqiptarin me përbuzje
9. sabah — u — mëngjes
10. gjysmëhëna — flamur turk që ka për shenjë gjysmëhënën.
11. xhehnet — parajsë
12. qostek-u — zinxhiri i sahatit
13. grah- nxit
14. sini-a — dhisk i madh prej bakri, që dikur

shërbente si sofër.

15. tagan — i — jatagan, shpatë me majë të harkuar
16. pisket — thërret
17. makth — i — ankth, frikë, tmerr
18. grykëhollë — pushkë me grykë të hollë
19. stërqokë — a — sorrë
20. gurre — burim
21. — varrë — a — plagë
22. grahmë — a — të hequrit shpirt me mundim
23. rropamë — a — zhurmë e madhe

Harxhi, B.

Mic Sokoli me shtatë zemra.

Poemë. T., «Naim Frashëri», 1980.

36 f. (B-ka e pionierit)

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.983-93-1

H 27

Tirazhi 3000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re,
Tiranë, 1980